

Skema e nëngrantimit është zbatuar në kuadër të projektit "**Siguria për Qeniet Njerëzore dhe Kufijtë – Luftimi i Kontrabandimit të Migrantëve në Ballkanin Perëndimor**", mbështetur nga Komisioni Europian

Zhvilluar në bashkëpunim me Grupin 484, Aleancën Qytetare (Mali i Zi), Shoqatën e Juristëve të Rinj Maqedonas, Vasa Prava (E drejta jote) Bosnje dhe Hercegovinë, Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Programin për të Drejtat Civile në Kosovë dhe Këshillin Danez për Refugjatët

Organizata zbatuese e nëngrantit: **Shoqata “Multifunksionale për Kulturë, Edukim dhe Zhvillim”**

Zona e zbatimit: Gjirokastrë

Periudha e zbatimit: Gusht 2021-Janar 2022

Objektivi i përgjithshëm i projektit është kontribuimi në ofrimin e shërbimeve psiko-sociale dhe ligjore për 150 migrantë ilegalë për një periudhë 6 mujore me qëllim parandalimin e kontrabandimit dhe respektimin e të drejtave të tyre.

Objektivat specifikë janë:

1. Të kontribuohet përmes ndërgjegjësimit dhe informimit të 150 migrantëve për rreziqet dhe pasojat që vijnë nga migrimi i paligjshëm, përmes medias.
2. Të nxitet reagimi ndërinstucional për ofrimin e shërbimeve efektive dhe menaxhimin e rasteve përmes tryezave multifunksionale
3. Të ofrohen shërbime psiko-sociale, ligjore dhe argëtuese me qëllim lehtësimin e traumave që mbartin gratë, fëmijët dhe personat me Aftësi Ndryshe.

Rezultatet të cilat synohet të arrihen janë:

- a) 3 tryeza për identifikimin e nevojave të migrantëve, shërbimet e munguara si dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore me përfaqësues të Bashkisë, medias, Drejtorisë së Migracionit dhe Kufirit, DSHP, CARITAS, Drejtorisë së Policisë.
- b) Prodhimi i 5 kronikave, 1 fushate mediatike, 1 emisioni televiziv dhe 2 rrëfimesh të migrantëve
- c) 400 fletëpalosje me qëllim informimin e migrantëve mbi shërbimet juridike dhe psiko-sociale
- d) 50 migrantë të mbështetur me shërbime ligjore
- e) 150 migrantë të mbështetur me shërbim këshillimi, asistencë shërbimi psikologjik dhe në zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme argëtuese, lojëra sportive, etj.